



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
DREJTORIA E FINANCES DHE BUXHETIT

Nr. 1979 / Prot, 114

Divjakë, më: 17/03./2026

PROJEKT-VENDIM
Nr. 31, Datë 17.03.2026

PËR NJË NDRYSHIM TË VENDIMIT NR.13 DATË 24.02.2025 “PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË NXËNËSVE ME ARRITJE TË SHKËLQYERA NË SHKOLLAT PUBLIKE TË BASHKISË DIVJAKË”

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 dt.17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja b, neni 23, pika 12, neni 24, neni 54, neni 55, Ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar ne Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 22, neni 23, neni 28, pika 4, shkronja b. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.632, datë 04.10.2004 “Për miratimin e dokumentit për politikën e decentralizimit në sektorin e arsimit parauniversitar”, Vendimit nr.13 datë 24.02.2025 “ Për mbështetjen financiare të nxënësve me arritje të shkëlqyera në Shkollat Publike të Bashkisë Divjakë”, I propozojmë Këshillit të Bashkisë Divjakë në mbledhjen e datës 30. 03. 2026:

Të Miratojë:

Ndryshimin e pikës 5 të Vendimit nr.13 datë 24.02.2025 “ Për mbështetjen financiare të nxënësve me arritje të shkëlqyera në Shkollat Publike të Bashkisë Divjakë”, e cila ishte:

*Mbështetje Finaciare në vitin mësimor për nxënësit ë shkollave publike që ndjekin arsimin e mesëm të ulët është 10 000 (dhjetë mijë) lekë në vit/nxënës gjithashtu dhe për nxënësit që ndjekin arsimin e mesëm të lartë është 10 000 (dhjetë mijë) lekë në vit/nxënës.

Kjo pikë ndryshon si më poshtë

- 5. Mbështetje Financiare në vitin mësimor për nxënësit e shkollave publike që ndjekin arsimin e mesëm të ulët është 15 000(pesëmbëdhjetë mijë) lekë/ vit gjithashtu dhe për nxënësit që ndjekin arsimin e mesëm të lartë është 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në vit/nxënës.**

Përgjegjës i Sektorit Juridik, Prokurimeve Publike dhe Menaxhimit Aseteve

Andi BULLARI

Përgjegjës I buxhetit dhe MFK

Irena GJONI

Drejtore i Financës dhe Buxhetit

Xheladin BRAHKOLA

